



Ambasada
e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë



deutscher oktober
tetori gjerman

Javët gjermane në Shqipëri 2019

Thirrje për sponsorizim



deutscher oktober
tetori gjerman

Ambasada Gjermane në Tiranë
Rruga Skenderbej 8
Tel. 00355 4 2274 505

Retrospektivë - Tetori Gjerman 2018: „Frymëzuar nga Njerëzit“

Një „**Faleminderit shumë!**“ duhet thënë edhe këtë vit që në fillim të kësaj thirrjeje për sponsorizim të Tetorit Gjerman. Fakti që ne kemi mundur të ngremë një traditë të javëve të kulturës gjermane në Shqipëri duke i ofruar publikut për çdo vit një program të larmishëm dhe ambicioz, ka qenë e mundur të realizohet vetëm falë bashkëpunimit të mirë dhe mbështetjes së sponsorizuesve tanë. **Për këtë përzemërsisht faleminderit!**

Tetori Gjerman 2018 u zhvillua nën moton „Frymëzuar nga njerëzit“. Përjetimet e përbashkëta dhe shkëmbimi i mendimeve e përvojave mes gjermanëve dhe shqiptarëve ishte edhe këtë herë ideja qendrore dhe elementi lidhës i Tetorit Gjerman. Këtu u frymëzua nga projektet gjermano-shqiptare në më shumë se 50 aktivitete duke u shndërruar kështu në frymëzim për mbi 7000 njerëz të tjerë. Me shfaqjet kulturore në teatër, kërcim, letërsi, film, muzikë por edhe në gastronomi dhe formim politik kemi mundur që së bashku me organizatat partnere t'i nxisim njerëzit të reflektojnë e të frymëzohen për diskutime të ndryshme rreth temash politike, ekonomike dhe shoqërore.



Tetori Gjerman 2019 - „gur, gur bëhet URË“

Edhe në vitin e trembëdhjetë të ekzistencës së tij ne dëshirojmë t'i qëndrojmë traditës së bukur të Tetorit Gjerman. Sërish do të përpiqemi që përmes projektesh interesante dhe idesh të reja të synojmë grupe të ndryshme në gjithë Shqipërinë dhe t'i entuziasmojmë ata për Gjermaninë, gjuhën dhe kulturën gjermane.

Në datën 9 nëntor 2019 shënohet 30-vjetori i rënies së Murit të Berlinit. Ne dëshirojmë të marrim shkas nga ky përvjetor për ta vendosur Tetorin Gjerman 2019 nën moton „gur, gur bëhet URË“. Rënia e Murit ka patur si për Gjermaninë ashtu edhe për mbarë Evropën një rëndësi të veçantë si simbol i „fitores së lirisë“. Viti 1989 konsiderohet si një kufi i rëndësishëm historik. Pas tij vijoi jo vetëm ribashkimi i Gjermanisë por edhe shndërrimi i sistemit dhe procese transformimi në shumë shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore, përfshirë Shqipërinë. Rrënojat e Murit të Berlinit ishin, jo pak, edhe një pjesë e themelit të ribashkimit të Evropës.

30 vjet më vonë ne dëshirojmë të hedhim sytë drejt të përbashkëtave dhe ndryshimeve në historitë e vendeve, por edhe në të tashmen e shoqërive tona. Krahas kësaj dëshirojmë të shtrojmë pyetjen se si mund të kapërcejmë bashkërisht mure dhe pengesa të vjetra e të reja, të dukshme e të padukshme. E këtu, edhe për këtë vit, synimi ynë mbetet që përmes aktiviteteve dhe projekteve tona të ngremë ura të shkëmbimit mes gjermanëve dhe shqiptarëve.

Disa prej ideve tona për vitin 2019

- Ne duam të ngjysim në skenë idenë e lirisë dhe kemi planifikuar një koncert klasik me pjesë të Beethoven-it, realizuar nga orkestra sinfonike e RTSh-së nën drejtimin e një dirigjenti gjermano-polak. Krahas kësaj dëshirojmë të sjellim për një koncert në Shqipëri të mirënjohurën Orkestrën Federale Gjermane të muzikës Jazz.
- Kërcimi dhe teatri do të na gëzojnë sërish në vitin 2019. Qendra Goethe ka planifikuar së bashku me regjisorin shqiptar Stefan Çapaliku vënien në skenat shqiptare të pjesës teatrale „Eldorado“ me autor Marius von Mayenburg. Pjesa rrëfen për një dallaveraxhi dinak, i cili prej ambjentit të tij familjar kinse-idilik bën pazare pronash në vende të largëta, të shkatërruara e pushtuara.
- Krahas kësaj planifikojmë një udhëtim letrar dygjuhësh të një autori gjermanofolës, i cili do të lexojë në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Temën e lirisë, vetëpërbushjes dhe tolerancës ndërnjerëzore duam ta trajtojmë edhe në projekte me nxënës gjermanishtfolës.
- Gjithashtu dëshirojmë që arti modern bashkëkohor gjerman të mbërrijë në mënyra të ndryshme. Kemi planifikuar një ekspozitë të fotografes gjermano-shqiptare Anna Ehrenstein, e cila në punët e saj përballet me autoperceptimin e gruas. Gjithashtu Qendra Goethe do të organizojë një rezidencë interaktive artistësh rreth Komunës së Parisit në lagjen me të njëjtin emër në Tiranë. Ndërsa me performancën e një DJ të ftuar duam të sjellim në Shqipëri disa *beats* të elektro-skenës berlineze.
- Në formate të ndryshme aktiviteteve do të vihen sërish në qendër tema mjaft aktuale shoqërore dhe politike. Kështu së bashku me partnerët tanë po planifikojmë konferenca dhe aktivitete rreth Procesit të Berlinit dhe stadi aktual të integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.

- Dhe natyrisht, pjesë e programit të Tetorit Gjerman do të jetë edhe tradicionalja: Festa e Birrës së DIHA-s shoqëruar me muzikë bavareze origjinale të tendave të birrës.

Këta janë vetëm disa shembuj nga gjithë sa kemi planifikuar. Ashtu si në vitet paraardhëse një pjesë e aktiviteteve do të organizohet nga vetë Ambasada Gjermane, të tjera nga institucionet tona partnere, por të gjitha do të koordinohen nga Sektori i Kulturës së Ambasadës Gjermane.

Pse të bëheni sponsor?

- Duke qenë sponsor ju mundësoni vijimin e traditës së Tetorit Gjerman dhe përfitoni prej imazhit të tij pozitiv si një aktivitet gjithëpërfshirës, por edhe prej aktiviteteve të veçanta të shumta, sikurse edhe prej emrit të mirë të Gjermanisë në Shqipëri.
- Ju shfrytëzoni si sipërmarrje gjermane ose gjermano-shqiptare opinionin pozitiv të publikut shqiptar përkundrejt Gjermanisë, produkteve dhe markave gjermane dhe kontribuoni në këtë aspekt me imazhin tuaj të mirë.
- Ne organizojmë aktivitete, të cilat bëhen temë bisedash e zgjojnë interes të madh në media dhe publik; zhvillojmë një punë aktive dhe profesionale me shtypin në formën e konferencave për shtyp, intervistave dhe materialeve promovuese shumëgjuhëshe. Përmes angazhimit të mediave sociale dhe atyre të partnerëve tanë arrijmë të përfshijmë grupe të interesuarish, veçanërisht ata të moshave më të reja.
- Ambasada Gjermane në rolin e saj si koordinatore e përgjithshme e Tetorit Gjerman mbështet cilësinë dhe transparencën e të gjitha aktiviteteve!

Çfarë përfitoni ju si sponsor prej gjithë kësaj?

Nëse vendosni të mbështesni Tetorin Gjerman 2019, do të përfitoni

- paraqitjen e emrit dhe logos së firmës në të gjitha publikimet rreth Tetorit Gjerman dhe në faqen e internetit të Ambasadës Gjermane
- përmendjen e emrit tuaj si sponsor nga ana e Ambasadores gjatë konferencës për shtyp me rastin e çeljes së Tetorit Gjerman
- ftesa në të gjitha aktivitetet e Tetorit Gjerman

Në të shkuarën kontributet e sponsorizuesve tanë në vlerën nga 500,- deri në 5000,- euro na kanë ndihmuar shumë.

Ju lutemi të na kontaktoni deri me datë 05.04.!

Nëse jeni të interesuar për sponsorizimin atëherë na kontaktoni. Për të lehtësuar planifikimin tonë lutemi për një përgjigje **deri me datë 05.04.2019.**

Z. Enrico Günther Drejtues i Sektorit të Kulturës dhe Shtypit E-Mail: ku-1@tira.diplo.de	Z. Artan Begolli Sektori i Kulturës E-Mail: ku-100@tira.diplo.de	Znj. Martina Held Sektori i Kulturës E-Mail: ku-10@tira.diplo.de
--	---	--